



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

BASHKIA RROGOZHINË

Tiranë, Dhjetor 2016

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, Bashkia Rrogozhinë.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes, miratuar me Vendimin nr.1, datë 06.01.2016, *“Mbi planin vjetor të punës për vitin 2016”*, ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë, nëpërmjet Vendimit nr. 6, datë 18.01.2016, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Rrogozhinë”*.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve të vitit 2015, organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë së Rrogozhinë, si njësi e qeverisjes vendore, përfshin edhe njësi të reja administrative të organizuara më parë si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, që janë: ish komunat Sinaballaj, Gosë, Lekaj dhe Kryevidh, të cilat, në bazë të ligjit nr. 30/2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”* të ndryshuar, aktualisht janë pjesë e strukturës së Bashkisë Rrogozhinë.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”* Kreu III, *“Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”* pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njërive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrirë. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, *“Transferimi i personelit”* parashikohet se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njërive që janë shkrirë dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të saj.

Në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes në këtë institucion, me objekt zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, është shtrirë edhe për njësitë administrative, pjesë përbërëse të strukturës së institucionit, Bashkia Rrogozhinë.

Sipas Programit të Mbikëqyrjes, nr. 40/1 prot., datë 18.01.2016, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 40/2 prot., datë 18.01.2016, “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes” grupi i punës u paraqit në institucion në datën 25.01.2016, ora 10:00.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe konsiston në verifikimin e mënyrës së zbatimit të gjithë instituteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, përpunoi të dhënat dhe përgatiti raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Bashkinë Rrogozhinë, duke përfshirë edhe Njësitë Administrative Sinaballaj, Gosë, Lekaj, Kryevidh.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përkrahimin e punës dhe detyrat që realizon secili funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm,

nr.8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;

- Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione që bëjnë pjesë të shërbimit civil sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
- Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e verifikimit dhe deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve (*kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e posaçme të vendit të punës, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.*).

3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në drejtimet e mëposhtme:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës?
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar?
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës?
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar. Si materializohet

procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).

11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin në institucion të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, si për institucionin Bashkia Rrogozhinë ashtu edhe për Njësitë Administrative, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, u realizua një takim me Drejtorin e Shërbimeve Mbështetëse z. Besmir Pone, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës për Bashkinë Rrogozhinë, si dhe për të gjitha Njësitë Administrative që janë pjesë përbërëse e saj.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listë prezencat e punonjësve për periudhën *shkurt 2014* dhe për periudhën *dhjetor 2015* si dhe evidenca e punonjësve, që njësitë administrative kanë dorëzuar pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Rrogozhinë.
- U verifikuan aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit civil për të gjithë nëpunësit e bashkisë dhe të njësisve administrative, të lëshuara nga njësia e personelit.
- U verifikuan procedurat e ndjekura për dhënien e masave disiplinore.
- U shqyrtuan aktet e vlerësimit të rezultateve në punë dhe mënyra e zhvillimit të këtij procesi pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Aneksi 1 dhe Aneksi 2*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e këtij projekt raporti.

Përmbajtja e raportit:

I. Si është kuptuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

a) Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes në Bashkinë Rrogozhinë.

I.a.1) Bashkia Rrogozhinë

Institucioni i kësaj bashkie është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, i cili e përcakton atë, si njësi të qeverisjes vendore, e si e tillë përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, ky institucion përfshihet në fushën e veprimit të këtij ligji, pasi, në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Menaxhimi i shërbimit civil në këtë institucion, është bërë mbi bazën e strukturave organizative të miratuara nga Këshilli Bashkiak, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar, i cili, në nenin 32, gërma "ç" përcaktonte se, struktura dhe organika e administratës së bashkisë, miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (datë 26.02.2014), Bashkia Rrogozhinë, ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës organike të miratuar me Vendimin nr. 13, datë 14.02.2014 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Rrogozhinë".

Sipas këtij vendimi, institucioni i bashkisë kishte gjithsej **39** pozicione pune, nga të cilat, **2** funksionarë politikë, **18** punonjës të sektorëve mbështetës, **3** policë bashkiakë dhe **16** pozicione bënin pjesë në shërbimin civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" ndarja e tyre bëhet në mënyrën e mëposhtme:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Përgjegjës Sektori".
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **12** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Specialist/Inspektor".

Referuar Vendimit nr. 15 , datë 14.02.2014, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e tabelës së pagave të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2014” rezulton se Këshilli Bashkiak kishte vendosur që institucioni do të trajtonte me pagë edhe **21** pozicione, të cilat nuk figurojnë në strukturën organike të miratuar me Vendimin nr. 13, datë 14.02.2014 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e strukturës organike të Bashkisë Rrogozhinë”.

Këto **21** pozicione nuk kanë të bëjnë me shërbimin civil, pasi bëhet fjalë për **4** pozicione pune “*administrator lagje*” dhe **17** pozicione pune “*këshilltarë*”.

Në lidhje me emërtesën e funksionit “*administrator lagje*” u krye një verifikim me qëllim që të saktësohej nëse këta punonjës e kishin përfituar statusin e nëpunësit civil sipas ligjit të mëparshëm të qeverisjes vendore (nr. 8652 dt. 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar), në përfundim të të cilit rezultoi se pozicionet e tyre të mëparshme nuk ishin përfshirë në strukturën organizative të bashkisë, dhe nuk trajtoheshin si “*administrator lagje*” në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” të ndryshuar, por si “*Kryepaq*” pra, punonjës me kohë të pjesshme, (me pagë 6930 lekë në muaj).

Njësia përgjegjëse e këtij institucioni, me të drejtë nuk i ka trajtuar si nëpunës civil, por i ka konsideruar si punonjës administrativë, njësi publike shërbimi, të cilët emërohen dhe shkarkohen nga kryetari i bashkisë.

I.a.2) Komuna Sinaballaj, aktualisht Njësia Administrative Sinaballaj

Nga analiza e dokumentacionit që u këqyr dhe u administrua nga grupi i mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (datë 26.02.2014), kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 1, datë 10.02.2014 të Këshillit të Komunës Sinaballaj.

Sipas kësaj strukture, kjo komunë kishte gjithsej **7** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **4** prej tyre plotësonin kushtet për t’u përfshirë në shërbimin civil, (të cilat zënë **57 %** të numrit total të pozicioneve të punës), kurse pjesa tjetër ishin pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” vlerësohet se të **4** këto pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i përkasin nivelit “*Specialist/Inspektor*”.

I.a.3) Komuna Gosë, aktualisht Njësia Administrative Gosë

Konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (datë 26.02.2014), kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 31.01.2014, të Këshillit të Komunës Gosë.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **15** pozicione pune, nga të cilat, **7** prej tyre plotësonin kushtet për t'u përfshirë në shërbimin civil, (që zënë rreth **46 %** të numrit total të pozicioneve të punës), kurse pjesa tjetër ishin pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" ndarja e tyre bëhet në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Përgjegjës Sektori".
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **3** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Specialist/Inspektor".

Pra siç shihet, raporti i pozicioneve sipas hierarkisë administrative nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, të cilat e kërkojnë këtë raport në të kundër të asaj çka konstatohet në këtë rast. Këto struktura kanë qenë evidente më parë, pasi rrisnin artificialisht nivelin e pagave të punonjësve të komunave.

I.a.4) Komuna Lekaj, aktualisht Njësia Administrative Lekaj

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, kjo njësi ishte e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikikës së miratuar me Vendimin nr. 4, datë 14.02.2014, të Këshillit të Komunës Lekaj.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **23** pozicione pune, nga të cilat, **11** prej tyre plotësonin kushtet për t'u përfshirë në shërbimin civil, (që zënë rreth **47 %** të numrit total të pozicioneve të punës), kurse pjesa tjetër ishin pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", ndarja e tyre bëhet në mënyrën e mëposhtme:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **5** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Përgjegjës Sektori".
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **6** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit "Specialist/Inspektor".

Edhe në këtë rast, konstatohet se raporti i pozicioneve sipas hierarkisë administrative nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, të cilat e kërkojnë këtë raport në të kundër asaj çka

konstatohet në këtë rast. Këto struktura kanë qenë evidente më parë, pasi rrisnin artificialisht nivelin e pagave të punonjësve të komunave.

I.a.5) Komuna Kryevidh, aktualisht Njësia Administrative Kryevidh

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 5, datë 31.01.2014 të Këshillit të Komunës Kryevidh.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo komunë kishte gjithsej **41** pozicione pune, nga të cilat, vetëm **11** prej tyre plotësonin kushtet për t’u përfshirë në shërbimin civil, (që zënë rreth **27 %** të numrit total të pozicioneve të punës) kurse pjesa tjetër ishin pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndarja e këtyre pozicioneve bëhet në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “Përgjegjës Sektori”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **7** pozicione pune, të cilat i përkasin nivelit “Specialist/Inspektor”.

► Në përfundim të përpunimit dhe analizimit të të dhënave të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, nga grupi i punës në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Rogozhinë dhe në Komunitat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se nga **146** pozicione pune në total, **49** pozicione bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Referuar nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, këto **49** pozicione, sipas nivelit të nëpunësisë, ndahen si më poshtë:

- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **17** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **32** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor”.

Ndërkohë, në momentin e mbikëqyrjes, sipas strukturës së institucionit, të miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me Urdhrin nr. 581 prot., datë 04.08.2015, “Për miratimin e strukturës

organizative të Bashkisë Rrogozhinë”, konstatohet një pakësim i pozicioneve të punës në shërbimin civil, ashtu dhe në numrin e përgjithshëm të tyre. Aktualisht, nga **101** vende pune në total, **47** pozicione pune, bëjnë pjesë në shërbimin civil. Në mënyrë të detajuar, kjo gjendje është pasqyruar në tabelën **Aneks nr. 3** - “*Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil, të Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësive Administrative për vitin 2015*”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Ndërkaq, duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, ndarja e këtyre pozicioneve bëhet në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **5** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Sekretar i Përgjithshëm/Drejtor Departamenti/Drejtor Drejtorie të Përgjithshme*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **8** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **34** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist/Inspektor*”.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e analizuara më sipër, është bërë një ndarje e drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit.

II. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me deklarinimin e statusit të punonjësve dhe nëpunësve aktualë.

Me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si në rastin e Bashkisë Rrogozhinë, e cila edhe më parë bënte pjesë në shërbimin civil, ashtu dhe ish komunave, të cilat u përfshinë për herë të parë në shërbimin civil, në bazë të nenit 67, të ligjit në fjalë, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*” i ndryshuar, njësia përgjegjëse kishte detyrimin të bënte deklarinimin e statusit të punësimit të punonjësve të tyre, brenda afateve të përcaktuara në këto akte.

Për kryerjen e këtij procesi, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka përcaktuar kriteret e mëposhtme:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues”,* punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë

11.11.1999 “*Statusi nëpunësit civil*” apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;

- *pika 4, “Nëpunësit ekzistues”,* që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit”,* sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse, pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*” Kreu II, “*Statusi i nëpunësve të tjerë civil në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*” pika 1, është përcaktuar se: “*Nëpunës civilë*”, sipas pikës 3, të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione në shërbimin civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit, pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune në shërbimin civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarin e statusit të punësimit, grupi i mbikëqyrjes verifikoi dhe analizoi të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, kohën e fillimit të punës, organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë efektive në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, (*listëprezencën dhe listëpagesën e muajit shkurt 2014*), si dhe aktet që pasqyrojnë procedurat e rekrutimit, në ato raste që ishin kryer, për nëpunësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Pas analizës së situatës, lidhur me statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, duke marrë si kriter procedurën e zbatuar për plotësimin e këtyre pozicioneve, situata rezulton si më poshtë:

II.a) Gjendja e deklaramit të statusit të punësimit në Bashkinë Rrogozhinë dhe Komunat (sot njësitë administrative përkatëse) në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, data 26.02.2014

II.a.1) Bashkia Rrogozhinë

Në Bashkinë Rrogozhinë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) ka pasur gjithsej, **16 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**, prej të cilave, njësia përgjegjëse ka bërë **9** deklarime statusi, me arsyetimin se vetëm këta punonjës përmbushnin kushtin e vjetërsisë në të njëjtin pozicion më shumë se një vit.

- Nga verifikimi i rasteve të deklarimit të statusit, është konstatuar se vetëm në **4** raste njësia përgjegjëse ka vepruar drejt. Është fjala për nëpunësit:
 - ***** , në pozicionin “Agronom”, emëruar me kontratë individuale pune nr.5/1 prot., datë 05.01.2012 dhe deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr. 325 prot., datë 20.04.2015;
 - ***** , emëruar me aktin e emërimit nr. 50 prot., datë 02.08.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Ekonomik” dhe deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr.326 prot., datë 20.04.2015;
 - ***** , në pozicionin “Inspektor Arsimi”, emëruar me kontratë individuale pune me nr. 5/1 prot., datë 05.01.2012 dhe deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr. 331 prot., datë 20.04.2015;
 - ***** , në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, emëruar në këtë pozicion në datë 07.03.2002, sipas librezës së punës dhe deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr. 323 prot., datë 20.04.2015.
- Kjo njësi ka gabuar për **3** raste të tjera, kur ka deklaruar statusin e punësimit “*nëpunës civil*”, në një kohë që këta punonjës kishin më pak se një vit në atë pozicion pune dhe duhej të deklaroheshin “*nëpunës civil në periudhë prove*”.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , “Punonjëse e ndihmës ekonomike” emëruar me urdhrin nr. 1, datë 01.02.2014, dhe deklaruar nëpunës civil me aktin nr. 328 prot., datë 20.04.2015;
- ***** , “Punonjës PAK + Arkë”, emëruar me urdhrin nr. 05, datë 12.07.2013, dhe deklaruar nëpunës civil me aktin nr. 327 prot., datë 20.04.2015;
- ***** , “Përgjegjës Sektori” emëruar me aktin nr. 10/9 prot., datë 10.09.2013, dhe deklaruar nëpunës civil me aktin nr. 330 prot., datë 20.04.2015. Deklarimi i tij është bërë si nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike”;

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të ndryshojë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, duke ndryshuar pozicionimin e tyre në raport me shërbimin civil, nga nëpunës civil në nëpunës civil në periudhë prove, duke u kujdesur më tej, që ata të përfundojnë trajnimin e detyrueshëm në ASPA dhe pas vlerësimit të rezultateve në punë, të konfirmohen nga eprori i tyre si nëpunës civil, nëse i përmbushin të gjitha kërkesat e nenit 24 të ligjit për nëpunësin civil.

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, e ka deklaruar punonjësën ***** si nëpunës civil, në pozicionin e punës “Veteriner”, nëpërmjet aktit administrativ nr.324 prot., datë 20.04.2015.

Konstatohet se punonjësi në fjalë, ka filluar punë në Bashkinë Rrogozhinë, me aktin administrativ nr. 2/7 prot., datë 02.07.2012, duke mos zhvilluar procedurat e rekrutimit, sipas ligjit të mëparshëm për shërbimin civil, në pozicionin e punës “Veteriner”.

Më pas, në datën 05.01.2014, (akti administrativ në këtë rast është pa numër protokolli), ky punonjës, përsëri në kundërshtim me ligjin e kohës, duke mos kryer procedurat e ngritjes në detyrë, ka kaluar përkohësisht në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike”, me klauzolën në akt, “deri në një urdhër të dytë”.

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur atë në këtë pozicion pune dhe normalisht, përfiton nga e drejta që ky ligj i njohu punonjësve që u gjenden në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, për t`u konsideruar si subjekte të tij.

Për këtë arsye, në kushte normale, njësia përgjegjëse duhet të bënte deklarin e statusit të punësimit të punonjësit në fjalë, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike”, në periudhë prove. Ndërkohë, rezulton se njësia përgjegjëse, me aktin nr. 324 prot., datë 20.04.2015, ka deklaruar statusin e punësimit të tij, në pozicionin e mëparshëm të punës, “Veteriner”.

Duke e analizuar rastin, në këndvështrim të ligjshmërisë së veprimeve të kryera në lidhje me zbatimin e ligjit, konstatohet se, me aktin nr. 8, datë 07.11.2014, titullari i institucionit, në plotësim të klauzolës së lënë në aktin e mëparshëm, përmendur në mënyrë specifike më sipër, punonjësi ka kaluar përsëri në pozicionin e tij, duke marrë parasysh kërkesën e tij, si veteriner, ku ende vijon që të kryej këtë detyrë.

Ulja në detyrë në këtë rast, ka ndodhur me pëlqimin e punonjësit, sipas aktit të datës 05.11.2014, administruar në dokumentet e këqyrura nga grupi i punës në institucion dhe nga verifikimi rezulton se akti administrativ nuk është ankimuar në gjykatë, ç`ka, konsiderohet si një rast atipik, i cili nuk ndalohet nga ligji dhe për pasojë, konsiderohet si i rregullt.

Në të njëjtin pozicion, me pëlqimin e tij, është sistemuar edhe pas implementimit të strukturës së re të institucionit, miratuar me aktin administrativ nr. 581 prot, datë 04.08.2015 që është nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë.

Nga analiza e zhvillimeve të mësipërme, arrihet në përfundimin se pavarësisht gabimit të bërë nga njësia përgjegjëse në momentin e deklarin të statusit, aktualisht është kapërcyer kjo mospërputhje dhe nëpunësi ***** mban pozicionin e punës “specialist veteriner”, për të cilin ai plotëson kërkesat e përgjithshme e të veçanta, e që përshtatet me statusin e punësimit të deklaruar nga njësia përgjegjëse.

Analiza e specifikuar e këtij rasti në këtë material, është theksuar me qëllim që të saktësohet mënyra e trajtimit të rasteve të ngjashme dhe përmirësimi i punës së njësia përgjegjëse në të ardhmen.

- Në **1** rast, është konstatuar që megjithëse ka qenë punonjës ekzistues për një periudhë më tepër se një vit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, ka bërë deklarin e statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të mungesës së nivelit arsimor, arsim i mesëm; (në mënyrë të detajuar shih **Tabelën nr. 1** – me titull: *Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil, i ndryshuar*).

Bëhet fjalë për punonjësin:

- ***** në pozicionin “*Jurist*”, emëruar me aktin e emërimit nr.15/8 prot., datë 15.08.2011 dhe deklaruar nëpunës civil, me aktin nr. 329 prot., datë 20.04.2015.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, punonjësi nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, për shkak të arsimit të mesëm, prandaj njësia përgjegjëse, për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë duhet të revokojë aktin e deklarin të statusit të punësimit të nëpunësit civil, duke ja komunikuar këtë akt dhe nëpunësit në fjalë. Për marrëdhënien e punësimit nuk është nevoja të shprehet, pasi ajo tashmë, ka përfunduar me aktin e dorëheqjes nr. 776/1 dt. 18.09.2015.

➤ Në **5** raste të tjera (që ishin punonjës ekzistues ditën e fillimit të efekteve të ligjit) njësia përgjegjëse me të drejtë ka refuzuar deklarin e statusit të punësimit pasi nuk përmbushnin kriterin arsimor, që kërkonte secili pozicion pune, sepse ishin me arsim të mesëm, apo nuk kishin edukimin arsimor të duhur për pozicionin e punës.

Konkretisht, në 2 raste nuk është deklaruar statusi për punonjësit si më poshtë:

- ***** në pozicionin “*Urbaniste*”, emëruar në datën 05.01.2011, me Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave. Aktualisht, kjo punonjëse vijon punën në pozicionin e Urbanistes, pranë Bashkisë Rrogozhinë.
- ***** në pozicionin “*Inspektor Ndërtimi*”, emëruar me urdhrin nr. 2/5 prot., datë 02.05.2012, me Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin Aleksandër Xhuvani Elbasan, degën Biologji-Kimi. Aktualisht është i punësuar pranë INUV (pozicion jashtë shërbimit civil).

Duhet theksuar këtu, që refuzimi i deklarin të statusit të punësimit në raport me shërbimin civil, për punonjësit ***** dhe ***** , përkatësisht në pozicionet “*Urbaniste*” dhe “*Inspektor Ndërtimi*” është se kërkesat e vendit të tyre të punës nuk përshtateshin me kualifikimin e tyre arsimor.

Konkretisht, ***** mban një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerave, ndërsa vendi i saj i punës kërkon arsim të lartë, diplomë “*Master i Shkencave/i Arteve të Bukura*”; “*Master Profesional*” “*Bachelor*”, në arkitekturë kurse *****; është i diplomuar në degën Biologji-Kimi, në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Universitetin “*Aleksandër Xhuvani*” Elbasan, ndërsa vendi i punës kërkon arsim të lartë, diplomë “*Master i Shkencave/i Arteve të Bukura*”; “*Master Profesional*”, “*Bachelor*”, sipas specifikës së përshkrimit të punës, në inxhinieri civile.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rogozhinë, ka vepruar drejt në lidhje me refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil, si për punonjësen *****; ashtu dhe për punonjësin *****. Por nga ana tjetër, rezulton se nuk kanë ndërprerë marrëdhënin e punësimit, ashtu siç e parashikon ligji.

Për këtë arsye, që të rregullohet situata e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rogozhinë, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësen *****; duke refuzuar statusin e nëpunësit civil, duke evidentuar faktin se nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të kriterit arsimor dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rogozhinë.

Ndërsa për punonjësin *****; është rregulluar gjendja e paligjshmërisë, për arsye të mungesës së statusit të nëpunësit civil, ka kaluar në një pozicion jashtë shërbimit civil, punonjës i INUV-it të Bashkisë Rogozhinë.

- Në 3 raste të tjera, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt, në lidhje me mosdeklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civil, pasi këta punonjës ishin me arsim të mesëm.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- *****; “*Inspektor Kulture dhe Sporti*”, emëruar me kontratë individuale pune nr.5/1 prot., datë 05.01.2012; aktualisht i punësuar në pozicionin “*Inspektor Sporti*” në Sektorin e Politikave, Projekteve në Kulturë/Rini/Sport, pranë Bashkisë Rogozhinë.
- *****; në pozicionin “*Urbanist*”, emëruar me urdhrin nr.5 prot., datë 12.07.2013. Punonjësi është liruar nga detyra me dorëheqje në datë 29.09.2015.
- *****; në pozicionin “*Inspektor Tatim Taksave + Magazinë*”, emëruar me urdhrin nr. 5 prot., datë 12.07.2013; aktualisht vijon i punësuar në të njëjtin pozicion “*Inspektor*” në Sektorin e Tatim Taksave, pranë Bashkisë Rogozhinë.

Sa më sipër, jemi para rastit, kur njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rogozhinë, ka vepruar drejt në lidhje me refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësit *****; ***** dhe *****.

Momenti i fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndyshuar, këta punonjës i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, por pavarësisht mosveprimit të

njesisë së personelit, ata nuk mund të përfitonin statusin e punësimit si nëpunës civil ekzistues për shkak të mungesës së arsimit të lartë.

Ndërkaq, nga grumbullimi i të dhënave, rezulton se, nga këta tre punonjës, 2 prej tyre janë të punësuar aktualisht pranë Bashkisë Rrogozhinë, ndërsa në një rast është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të dorëheqjes.

Bëhet fjalë për punonjësit ******, i cili aktualisht mban pozicionin “Inspektor Sporti” në Sektorin e Politikave, Projekteve në Kulturë/Rini/Sport, dhe ******, i cili vijon të jetë i punësuar në të njëjtin pozicion pune, “Inspektor” në Sektorin e Taksave, pranë Bashkisë Rrogozhinë.

Punonjësit në fjalë nuk mund të mbajnë këto pozicione pune, pikërisht për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Për këta punonjës, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, që të rregullohet situata e paligjshmërisë, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e lartpërmendur, duke evidentuar faktin se, nuk i përmbushin kriteret për të qenë nëpunës civil për shkak të kriterit arsimor dhe pozicionet e tyre të punës të shpallen të lira për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rrogozhinë.

➤ 2 pozicione pune kanë qenë të lira, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

II.a.2) Komuna Sinaballaj, aktualisht Njësia Administrative Sinaballaj.

Në ish Komunën Sinaballaj, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), vetëm 4 pozicione pune plotësonin kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, prej të cilave:

➤ Në 2 raste, është konstatuar që megjithëse kanë qenë punonjës ekzistues për një periudhë më tepër se një vit, njësia përgjegjëse e ish Komunës, nuk e ka bërë deklarinimin e statusit të punësimit (në mënyrë të detajuar, shih **Tabelën nr. 1** – me titull: *Nëpunës civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*).

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- ******, në pozicionin “Administratore Shoqërore”, emëruar me urdhrin nr. 69 prot., datë 31.05.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për

nëpunësin civil”, i ndyshuar, ajo e plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunëse civile, por ky veprim, pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të Komunës. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes kjo punonjëse konstatohet se ishte larguar nga detyra, me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 638 prot., dt. 20.08.2015, sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

Sa më sipër, jemi para rastit, kur njësia e personelit të Bashkisë Rrogozhinë, e ka trajtuar gabim problemin, pasi në kushtet kur kësaj punonjëseje, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i ka lindur e drejta për të përfituar statusin e nëpunësit civil dhe nuk mund të largohet nga puna sipas dispozitave të Kodit të Punës. Nga përmbajtja e aktit nr. 638 prot., dt. 20.08.2015, për ndërprerjen e marrëdhënies të punës, për punonjësen në fjalë, rezulton se largimi ka ndodhur për shkak të ristrukturimit dhe për këtë arsye duhet vepruar sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndyshuar.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunëse civile, për punonjësen ***** dhe në zbatim të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, t’i njoftohet e drejta që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, mund të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.

- ***** , në pozicionin punonjës në *“Zyrën e Shërbimeve”*, emëruar në datën 30.10.1992 (bazuar në listëpagesën e vitit 1992). Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndyshuar, punonjësi plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por ky veprim, pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse e ish Komunës Sinaballaj. Aktualisht, punonjësi ***** e ka lënë pozicionin e punës punonjës i *“Zyrës së Shërbimeve”*, për arsye ristrukturimi dhe me dëshirën e tij, ka kaluar në pozicionin e punës *“Arkivist Protokollist”*.

Nisur nga sa më sipër, momenti i fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, e ka gjetur në pozicionin punonjës në *“Zyrën e Shërbimeve”*, për një periudhë më shumë se një vit. Për këtë arsye, këtij punonjësi i ka lindur e drejta për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil për shkak të ligjit. Duke qenë se pozicioni aktual *“Arkivist Protokollist”*, është nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, pra i njëjti me atë që nëpunësi ka pasur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kalimi duhet të vlerësohet i ligjshëm.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësin ***** në pozicionin e punës, punonjës në *“Zyrën e*

Shërbimeve” dhe emërimi i tij, në pozicionin e punës “*Arkivist Protokollist*” të vlerësohet si i ligjshëm.

- *****, emëruar në datën 31.07.1993, në ish Komunën Sinaballaj, specialist në “*Zyrën e Financës*” (bazuar në listëpagesën e vitit 1993). Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, është gjendur në këtë pozicion, por pavarësisht mosveprimit të njësisë së personelit, ai nuk mund të përfitonte statusin e punësimit si nëpunës civil ekzistues për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Aktualisht mban pozicionin “*Inspektor i Taksave dhe Tarifave*”, pozicion të cilin nuk mund ta mbajë, pikërisht për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Për këtë punonjës, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë refuzimin e statusit të nëpunësit civil dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, duhet të nxjerrë, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Inspektor i Taksave dhe Tarifave*”, aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit, në zbatim të nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke evidentuar faktin se, nuk përmbush kriterin arsimor për të qenë nëpunës civil.

Pozicioni i punës duhet të shpallet i lirë, për t`u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Rrogozhinë.

- Në **1** rast, për një të punësuar i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishte i punësuar për një periudhë më pak se një vit, njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk ka bërë deklarinimin e statusit të punësimit, *nëpunës civil në periudhë prove*.

Bëhet fjalë për punonjësin:

- *****, punonjës në “*Zyrën e Financës*”, emëruar me urdhrin nr. 2 prot., dt.20.05.2013. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ai e plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil në periudhë prove, por siç u tha më lart, ky veprim pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të komunës. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, edhe ky punonjës konstatohet se ishte larguar nga detyra (*me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 639 prot. dt. 20.08.2015*).

Pra, jemi para një rasti tjetër që njësia e personelit të Bashkisë Rrogozhinë e ka trajtuar gabim problemin. Në kushtet kur këtij punonjësi, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i ka lindur e drejta për të përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove, nuk mund të largohet nga puna sipas dispozitave të Kodit të Punës. Nga përmbajtja e aktit nr. 639 prot. dt. 20.08.2015 për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, rezulton se largimi ka ndodhur për shkak të

ristrukturimit dhe për këtë arsye duhej vepruar sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, punonjësi ***** për shkak se nuk mundi të përfundojë periudhën e provës; nuk arriti të përmbushë detyrimet që përmban plotësimi i kësaj faze të pranimit në shërbimin civil (si kryerja e trajnimit të detyrueshëm në ASPA, kryerja e vlerësimeve të pjesshme, etj.), si dhe mungesa e interesimit për realizimin e të drejtave të tij, konsiderohet si humbje e statusit.

➤ Nuk rezultojnë pozicione të lira, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

II.a.3) Komuna Gosë, aktualisht Njësia Administrative Gosë.

Në ish Komunën Gosë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) konstatohet se ka pasur 7 pozicione pune, që plotësonin kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil.

- Megjithëse këto pozicione, kanë qenë të plotësuara me punonjës ekzistues të punësuar për më tepër se një vit kohë, njësia përgjegjëse, për asnjërin prej tyre nuk ka bërë deklarinimin e statusit të punësimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës” emëruar me urdhrin nr. 04 prot., datë 06.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por ky veprim pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të komunës Gosë. Aktualisht, punonjësi mban pozicionin “Specialist finance”, pranë Njësisë Administrative Gosë, detyrë të cilën ai e ka pranuar me dëshirën e tij, ç’ka vërtetohet edhe me deklaratën e tij me shkrim, dt. 18.08.2015.

- ***** , i punësuar në pozicionin “Jurist & Punonjës Arkive”, emëruar me urdhrin nr. 04/11 prot., datë 06.07.2011, pozicion të cilin e mban edhe aktualisht, njësia përgjegjëse ka gabuar kur nuk ka kryer deklarinimin e statusit të punësimit.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës kishte më shumë se një vit në të njëjtin pozicion pune, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, për rregullimin e ligjshmërisë në këto raste, duhet të nxjerrë aktin e deklarinimit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësin ***** në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”

pasi, fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion pune, për një periudhë më shumë se një vit.

Duke qenë se, punonjësi me dëshirën e tij ka kaluar në pozicionin “Specialist finance”, kalimi duhet të vlerësohet i ligjshëm.

Gjithashtu, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësin *****, në pozicionin “Jurist & Punonjës Arkive”, pasi, fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion pune, për një periudhë më shumë se një vit.

Në mënyrë të detajuar kjo pasqyrohet në **Tabelën nr. 1** – (Nëpunës civil, të cilëve nuk u është deklaruar statusi i punësimit);

- *****, në pozicionin specialist “Agronom”, emëruar me urdhrin nr. 04/7 prot., datë 06.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës plotëson kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por edhe në këtë rast, njësia përgjegjëse pa të drejtë, nuk e ka kryer këtë veprim administrativ.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes u konstatua se ky punonjës ishte larguar nga detyra për braktisje të punës. Fillimisht, për disa shkelje të herëpashershme të disiplinës, ndaj tij është aplikuar në 3 raste, masa disiplinore “vërejtje” (pavarësisht se emërtimin e masës “vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” e kanë vënë ndryshe nga emërtimi që përdor ligji). Pas marrjes së këtyre masave, ky punonjës nuk është paraqitur më në punë dhe ndaj tij me aktin nr. 646 prot., dt. 20.08.2015 “Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për punonjësin me kontratë pune Durim Sheshi”, është vendosur ndërprerja e marrëdhënies së punës. Ndaj kësaj mase nuk ka asnjë reagim prej punonjësit në fjalë.

Duke analizuar rrethanat e këtij rasti vërehet se, në kushtet kur punonjësi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka lindur e drejta për të përfituar statusin e nëpunësit civil, për largimin nga detyra, ndaj tij nuk mund të zbatoheshin dispozitat e Kodit të Punës, por duheshin zbatuar procedurat e parashikuara nga legjislacioni i shërbimit civil, nenet 57-61, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitat e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave në krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbim civil”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore” etj.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur punonjësi ***** pa arsye të ligjshme nuk është paraqitur në punë që prej datës 20.08.2015, si dhe nuk ka përdorur mundësitë për mbrojtjen nga veprimet e ndërmarra nga ana e Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë në lidhje me urdhrin për largimin nga puna, duhet të konsiderohet si braktisje e statusit dhe vërejtjet për shkeljen e procedurës, duhet t’i shërbejnë njësisë përgjegjëse, për përmirësimin e punës në të ardhmen.

- Në njësinë Administrative Gosë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kanë qenë 2 punonjës të cilët ndonëse të punësuar për më tepër se një vit, janë larguar nga detyra me dëshirën e tyre (*me dorëheqje*).

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

- *****, e punësuar në pozicionin “*Punonjëse arshive dhe e marrëdhënieve me publikun*”, emëruar me urdhrin nr. 04/4 prot., datë 06.07.2011. (*Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, kjo punonjëse konstatohet se ishte larguar nga detyra me dorëheqje, me urdhrin e liritimit nr. 1279 prot., datë 09.12.2015*),
- *****, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve*” emëruar me urdhrin nr.04/6 prot., datë 06.07.2011. (*Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes ky punonjës konstatohet se ishte larguar nga detyra me dëshirën e tij, me dorëheqje me urdhrin e liritimit nr. 626 prot., datë 19.08.2015*).

Duke analizuar veprimet e njësisë përgjegjëse në dy rastet e mësipërme, vërehet se është zbatuar gabim ligji. Nisur nga përmbajtja e akteve të liritimit nga detyra të dy punonjësve të lartpërmendur, njësia përgjegjëse në kundërshtim me ligjin nuk i ka trajtuar këta punonjës si pjesë e shërbimit civil, por sipas dispozitave të Kodit të Punës, mbi bazën e të cilave ka bërë dhe lirim nga detyra.

Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, punonjësja ***** plotësonte kushtet për të përfutur statusin e punësimit si nëpunëse civile. Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të kishte vepruar sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në nenin 64, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi të deklaronte statusin e punësimit, si nëpunëse civile për këtë punonjëse.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, për rregullimin e ligjshmërisë në këtë rast, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunëse civile, për punonjësen ***** dhe në zbatim të pikës në zbatim të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’i njoftohet e drejta që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, mund të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.

➤ Ndërsa, punonjësi ***** në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është gjendur në pozicionin “*Përgjegjës Zyrës Tatimeve*”. Pavarësisht mosveprimit të njësisë së personelit për implementimin e nenit 67, të ligjit në fjalë, punonjësi nuk mund të përfutonte statusin e punësimit si nëpunës civil ekzistues, për shkak se nuk përmbushte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte vendi i punës “*Përgjegjës Zyrës Tatimeve*”, (për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues kërkohet posaçërisht, master shkencor ose profesional), të cilin ky punonjës nuk e kishte.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, ka vepruar drejt në lidhje me refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjës in ******, pasi ky punonjës, nuk përmbush kriterin e nivelit arsimor që kërkonte vendi i punës.

- Në 2 raste të tjera, për punonjës in ******, mbajtës i pozicionit “Përgjegjës i Zyrës Tatimeve”, emëruar me urdhrin nr. 04/5 prot., datë 06.07.2011, dhe ******, mbajtës i pozicionit “Përgjegjës i Zyrës së Burimeve Njerëzore, Administrim dhe Ndihmë Ekonomike”, emëruar me urdhrin nr. 04/8 prot., datë 06.07.2011 (të cilët ishin punonjës ekzistues ditën e fillimit të efekteve të ligjit), njësia përgjegjëse me të drejtë nuk ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, pasi të dy punonjës in e mësipërm, nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor që kërkonte vendi i punës (DINP - Diplomë e Integruar e Nivelit të Parë), por ishin me arsim të mesëm (në mënyrë të detajuar shih **Tabelën nr. 1** – me titull: *Nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*).

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes konstatohet se, këta punonjës ishin të larguar nga detyra në bazë të dispozitave të Kodit të Punës (me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 735 prot. dt. 10.09.2015). Largimi nga detyra e punonjësve të lartpërmendur, duhej bërë në bazë të ligjit për shërbimin civil, duke u shprehur për refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit dhe përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbim civil, duke evidentuar faktin e mospërmbushjes së kriterit për nivelin arsimor.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, ka vepruar drejt në lidhje me refuzimin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil, si për punonjës in ******, ashtu dhe për punonjës in ******, pasi të dy punonjës in, nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor që kërkonte vendi i punës.

➤ Nuk rezultojnë pozicione të lira pune, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

II.a.4) Komuna Lekaj, aktualisht Njësia Administrative Lekaj

➤ Në ish Komunën Lekaj, aktualisht Njësia Administrative Lekaj, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) ka pasur gjithsej, **11 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**, prej të cilave, **8 pozicione**, kanë qenë të zënë me punonjës ekzistues, të punësuar më tepër se një vit në atë pozicion; **1 rast**, ka qenë punonjës ekzistues për një periudhë më pak se një vit; dhe në **2 raste** pozicionet e punës kanë qenë të lira.

- Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit vetëm në **4 raste**, me pretendimin se vetëm këta punonjës plotësonin kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- ******, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, mbante pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”. Në këtë pozicion është emëruar me urdhrin nr. 2 prot., datë 01.07.2011 dhe është deklaruar nëpunës civil me aktin e deklarimit të statusit të punësimit. (numër protokollit nuk ka) dt. 11.04.2014, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”. Aktualisht, mban pozicionin “Specialist finance”, pranë Njesisë Administrative Lekaj, detyrë të cilën e ka pranuar me dëshirën e tij, ç’ka vërtetohet edhe me deklaratën e tij me shkrim, dt. 18.08.2015.

- ******, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit mbante pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Tatim-Taksave”. Në këtë pozicion është emëruar me kontratë individuale pune, datë 01.07.2011 dhe është deklaruar nëpunëse civile me aktin e deklarimit të statusit të punësimit (numër protokollit nuk ka) datë 11.04.2014, në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Tatim-Taksave”. Aktualisht, mban pozicionin “Inspektore e Tatim-Taksave”, pranë Njesisë Administrative Lekaj, detyrë të cilën e ka pranuar me dëshirën e saj, ç’ka vërtetohet edhe me deklaratën e saj me shkrim, dt. 18.08.2015.

- ******, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit mbante pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Përkrahjes Sociale”. Në këtë pozicion është emëruar me kontratë individuale pune (numër protokollit nuk ka) datë 30.06.2011 dhe është deklaruar nëpunëse civile, me aktin e deklarimit të statusit të punësimit datë 11.04.2014 në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës së Përkrahjes Sociale”. Aktualisht, mban pozicionin “Specialiste e Përkrahjes Sociale” pranë Njesisë Administrative Lekaj, detyrë të cilën e ka pranuar me dëshirën e saj, ç’ka vërtetohet edhe me deklaratën e saj me shkrim dt. 18.08.2015.

- ******, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ka qenë i punësuar në pozicionin “Specialist Bujqësie & Agronom”, pozicion në të cilin është emëruar me urdhrin nr. 2 prot., datë 01.08.2011. Njësia përgjegjëse me të drejtë ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil (numër protokollit nuk ka) datë 11.04.2014, në pozicionin e punës “Agronom”.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, konstatohet se, ky punonjës ishte larguar nga detyra e mësipërme (me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 735 prot., dt.10.09.2015) si pasojë e ristrukturimit të Njesisë Administrative Lekaj (me motivacioni e shkurtimit të vendit të punës, etj.).

Megjithëse në këtë rast, konstatohet se nuk është kryer siç duhet procedura e parashikuar nga neni 50 i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore e ka riemëruar në pozicionin e punës specialist “Agronom”, me aktin e emërimit numër 1548 prot., datë 14.07.2016, pranë ish komunës Gosë, aktualisht njësia administrative e Bashkisë Rrogozhinë, (fakt i cili i është bërë me dije Komisionerit, pas dërgimit të projektraportit të mbikëqyrjes) duke respektuar të drejtën që gëzonte në bazë të pikës 8, të nenit 50, të ligjit në fjalë, që brenda një periudhe 2-vjeçare, mund të konkurronte nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, etj., në pozicione të njëvlerëshme brenda shërbimit civil.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, deklarimi i statusit të punësimit, për tre rastet e mësipërme, me të drejtë është bërë në pozicionin që punonjësit kanë patur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit, nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, por meqenëse këta nëpunës kanë pranuar të punojnë në pozicione të reja pune, të një niveli më të ulët, ky fakt duhet të evidentohet në Regjistrin e Personelit, me qëllim që të aplikohet drejtë procedura në sistemin e karrierës (lëvizje paralele, ngritje në detyrë). Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Ndërsa në rastin e nëpunësit ******, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë ka vepruar drejtë në lidhje me rrimërimin e tij duke respektuar në këtë rast të drejtën që parashikon pika 8, e nenit 50, të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, që brenda një periudhe 2-vjeçare, mund të konkurronte nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, etj., në pozicione të njëvlerëshme brenda shërbimit civil.

- Në 3 raste të tjera (të cilat ditën e fillimit të efekteve të ligjit ishin zënë me punonjës ekzistues) njësia përgjegjëse me të drejtë nuk ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të punësimit, pasi punonjësit nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor, që kërkonte secili prej pozicioneve të punës.

Konkretisht, nuk është deklaruar statusi për punonjësit:

- ******, në pozicionin *“Përgjegjës Administrate”*, i emëruar me kontratë individuale pune, datë 03.01.2012. Ky punonjës nuk përmbushte kriterin e arsimit të lartë, pasi ishte me arsim të mesëm, prandaj nuk mund të përfitonte statusin e nëpunësit civil, megjithëse ditën e fillimit të efekteve të ligjit 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kishte më shumë se një vit në atë pozicion pune.

Aktualisht, mban pozicionin *“Arkivist protokollist”* pranë Njesisë Administrative Lekaj, pozicion të cilin nuk mund ta mbajë, pikërisht për shkak të mungesës së arsimit të lartë.

Për këtë punonjës, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rrogozhinë.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjës in ***** i cili aktualisht mban pozicionin e punës “*Arshivist protokollist*” pranë Njesisë Administrative Lekaj dhe pozicioni i punës të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rrogozhinë.

- ***** , në pozicionin “*Specialist Finance*”, i emëruar me urdhrin nr. 5 prot., datë 15.02.2012. Duke qenë se ai nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor për këtë vend pune, me të drejtë nuk është deklaruar statusi i punësimit. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes ky punonjës ishte larguar nga detyra (me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr.642 prot., dt. 20.08.2015), veprim i cili konsiderohet i ligjshëm.

- ***** , në pozicionin “*Specialist Blegtorie*”, emëruar me urdhrin nr. 9 prot., datë 30.06.2011. Duke qenë se ai nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor për këtë vend pune, me të drejtë nuk është deklaruar statusi i punësimit. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, ky punonjës ishte larguar nga detyra (me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr.642 prot., dt. 20.08.2015), veprim i cili gjithashtu, konsiderohet i ligjshëm.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë ka vepruar drejtë në lidhje me refuzimin e deklarimit të statusit të punësimit, pasi punonjës in ***** dhe ***** nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor, që kërkonte secili prej pozicioneve të punës.

• Në 1 rast (punonjës ekzistues ditën e fillimit të efekteve të ligjit) njësia përgjegjëse pa të drejtë, nuk ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit.

Bëhet fjalë për punonjës in:

- ***** , në pozicionin “*Inspektor Tatim Taksave*”, emëruar me kontratë individuale pune, datë 01.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndyshuar, ky punonjës plotësonte kushtin për të përfitur statusin e punësimit si nëpunës civil, por akti i deklarimit të statusit, pa të drejtë, nuk është nxjerrë nga ana e njesisë përgjegjëse të Komunës Lekaj.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes ky punonjës konstatohet se ishte larguar nga detyra, në dt. 25.06.2015. Kjo e dhënë del nga listëpagesat, pasi në dosjen e tij nuk gjendej asnjë akt mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Në këto rrethana njësia përgjegjëse, duhet të sqarojë situatën e marrëdhënies së punësimit të këtij punonjësi, në momentin e mbikëqyrjes, duke u shprehur me aktin përkatës, për vijimin apo ndërprerjen e saj.

Nisur nga sa më sipër, në momentin e fillimit të efekteve të të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, këtij punonjësi i ka lindur e drejta për të përfitur statusin e punësimit si nëpunës civil për shkak të ligjit. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë në

këtë rast duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në pozicionin “Inspektor Tatim Taksash”. Në zbatim të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’i njoftohet nëpunësit e drejta që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, punonjësi ka të drejtë të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, etj.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësin ***** në pozicionin “Inspektor Tatim Taksave”, dhe në zbatim të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, t’i njoftohet nëpunësit e drejta që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, punonjësi ka të drejtë të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji.

- Në **1** rast, për një të punësuar, i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit ishte i punësuar për një periudhë më pak se një vit, njësia përgjegjëse nuk ka bërë deklarimin e statusit të punësimit, *nëpunës civil në periudhë prove* (në mënyrë të detajuar shih **Tabelën nr.2 – Nëpunës civil në periudhë prove, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**).

Bëhet fjalë për punonjësin:

- ***** , i cili është emëruar me urdhrin nr. 9 prot., datë 20.11.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil në periudhë prove, por ky veprim pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të Komunës Lekaj. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes ky punonjës konstatohet se ishte larguar nga detyra me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 610/2 prot. dt. 12.08.2015. Ndërprerja e marrëdhënies së punës, është bërë pa respektuar procedurat e parashikuara nga ligji, në rastet e ristrukturimit, me motivacionin e shkurtimit të vendit të punës, etj.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë duhet të kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës” dhe të tregonte kujdes për plotësimin e kushteve për përfundimin e periudhës së provës, sipas kërkesave të nenit 24 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe konfirmimin si nëpunës civil.

Aktualisht, punonjësi në fjalë është ankuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe ka fituar procesin gjyqësor me vendim të formës së prerë, dëmshpërblimin, duke u trajtuar sipas Kodit të Punës.

Ky fakt vërtetohet dhe me procesverbalin e mbajtur midis Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse të Bashkisë Rrogozhinë dhe grupit të mbikëqyrjes, datë 29.01.2016.

- 2 pozicione pune kanë qenë të lira.

II.a.5) Komuna Kryevidh, aktualisht Njësia Administrative Kryevidh

Në përfundim të përpunimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e shërbimit civil në ish Komunën Kryevidh, aktualisht Njësia Administrative Kryevidh, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kanë rezultuar gjithsej 11 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, prej të cilave, në 9 pozicione, kanë qenë punonjës ekzistues për më tepër se një vit; dhe në 2 pozicione, kanë qenë punonjës ekzistues për më pak se një vit;

- Njësia përgjegjëse vetëm në **3** raste ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit, me arsyetimin se, vetëm këta punonjës plotësonin kushtin për të fituar statusin e punësimit si nëpunës civil.

Bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , i cili është emëruar me kontratë individuale pune, datë 01.07.2011, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës” dhe meqenëse ditën e fillimit të efekteve të ligjit (26.02.2014) ka pasur më shumë se një vit në atë pozicion, me të drejtë është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil, me aktin nr. 204/3 prot., datë 04.04.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”. Aktualisht, mban të njëjtin pozicion pune “Përgjegjës Sektori ” në Drejtorinë e Politikave Urbane (emërtim pas ristrukturimit) pranë Bashkisë Rrogozhinë.

- ***** , i cili është emëruar me kontratë individuale pune, datë 01.07.2011, (numër protokollit nuk ka) në pozicionin “Këshilltar i Kryetarit dhe Jurist” dhe në momentin e fillimit të efekteve të ligjit (26.02.2014), është deklaruar si nëpunës civil, me aktin nr. 204 prot., dt. 14.04.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike”. Ky deklaram statusi përmban një parregullsi, pasi nëpunësi në fjalë nuk ishte “Përgjegjës i Zyrës Juridike” dhe vetë pozicioni nuk ekzistonte në strukturën e komunës.

Aktualisht mban pozicionin “Jurist”, pranë Njesisë Administrative Kryevidh, detyrë të cilën e ka pranuar dhe e ka kryer dhe më parë, gjë që vërtetohet me deklaratën e tij me shkrim, datë 18.08.2015.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të revokojë aktin e deklaramit të statusit për punonjësin ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike” dhe të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit në pozicionin e punës që ai mban aktualisht, “Jurist” pranë Njesisë Administrative Kryevidh.

- ***** , i cili është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve”, me kontratë individuale pune, datë 01.07.2011. Me aktin nr. 204/2 prot., datë 14.04.2015 të

njesisë së burimeve njerëzore është deklaruar statusi i tij i punësimit si nëpunës civil në atë pozicion.

Aktualisht, mban pozicionin “*Specialist Tatim-Taksash*”, pranë Njesisë Administrative Kryevidh, detyrë në të cilën ka kaluar me pëlqimin e tij për arsye ristrukturimi, ç’ka vërtetohet edhe me deklaratën me shkrim, datë 18.08.2015.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, pozicioni aktual i nëpunësit ***** është i një niveli më të ulët se ai që ka pasur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kalimi i tij në pozicionin “*Specialist Tatim-Taksash*”, duhet të vlerësohet i ligjshëm.

- Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë ka gabuar në rastin e nëpunësit ***** , i cili në momentin e fillimit të efekteve të ligjit kishte vetëm pak ditë që kishte filluar punë në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës Z.M.M.T*”, emëruar me kontratën individuale të punës, datë 03.02.2014. Për këtë rast, deklarimi i statusit të punësimit, në bazë të pikës 4, të nenit 67, të ligjit nr 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i duhej të ishte nxjerrë nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Përgjegjës i Zyrës së MMT*” dhe jo nëpunës civil, siç është shprehur, në aktin nr. 204/1 prot., datë 14.05.2015 të njesisë përgjegjëse. Pas deklarimit të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse duhej të tregonte kujdes për plotësimin e kërkesave të nenit 24 të ligjit në fjalë për kryerjen e periudhës së provës dhe konfirmimin si nëpunës civil, detyrë të cilën ajo nuk e ka kryer.

Aktualisht, nëpunësi ***** , e ka lënë pozicionin “*Përgjegjës i ZMMT*” për arsye ristrukturimi dhe mban pozicionin “*Specialist bujqësie*”, pranë Njesisë Administrative Kryevidh, detyrë të cilën e ka pranuar me dëshirën e tij, gjë që vërtetohet edhe me deklaratën e tij me shkrim datë 18.08.2015).

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të ndryshojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 204/1 prot., datë 14.05.2015 për punonjësin ***** , nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”. Pavarësisht se, periudha e provës si afat ka përfunduar dhe punonjësi është ulur në detyrë njësia përgjegjëse, të kujdeset për përmbylljen e detyrimeve që i përkasin plotësimin të periudhës së provës (*siç janë, kryerja e trajnimit të detyrueshëm në ASPA dhe vlerësimi vjetor*) dhe në eventualitetin e një rezultati pozitiv, ta konfirmojë atë nëpunës civil në pozicionin “*Specialist bujqësie*”.

- Në 3 raste punonjësit, ditën e fillimit të efekteve të ligjit plotësonin kushtet për të fituar statusin e punësimit si nëpunës civil dhe njësia përgjegjëse pa të drejtë ka refuzuar deklarimin e statusit të punësimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

- ***** , i punësuar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, me urdhrin e emërimit nr. 1/19, datë 01.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por ky veprim, pa arsye të ligjshme, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të Komunës Kryeveidh.

Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, ky punonjës konstatohet se ishte larguar nga detyra me dëshirën e tij (*me dorëheqje*), me urdhrin e lirimit nr. 37 prot., datë 01.07.2014, pra para fillimit të efekteve të ligjit nr. 30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Duke analizuar rastin në fjalë, arrihet në përfundimin se njësia përgjegjëse, ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhej që për nëpunësin ***** , të kishte nxjerrë aktin e deklarimit të statusit, si nëpunës civil dhe në momentin që ka dhënë dorëheqjen, bashkë me lirimin e tij nga detyra duhej t’i kishte bërë të ditur, të drejtën që gëzon në bazë të pikës 4, të nenit 64, të ligjit në fjalë, që brenda një periudhe dy vjeçare të mund të konkurronte në një pozicion tjetër, analog, në shërbimin civil, etj. Në kushtet e sotme, kur njësia përgjegjëse nuk ka vepruar, kur vetë punonjësi ka treguar pasivitet dhe për më tepër, tashmë ka kaluar edhe afati 2-vjeçar nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies në shërbimin civil, vërejtjet e mësipërme duhet t’i vlejnjë njësisë së personelit për të përmirësuar zbatimin e ligjit në të ardhmen.

- ***** , i punësuar në pozicionin “Specialist Finance dhe Arkë”, me kontratën individuale të punës, datë 01.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës plotësonte kushtin për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por ky veprim administrativ pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të Komunës Kryeveidh.

Ai është liruar nga kjo detyrë në dt. 02.04.2014 dhe ka pranuar të punësohet pranë Gjendjes Civile të Bashkisë Rrogozhinë, pozicion i cili nuk është pjesë e shërbimit civil.

Në kushtet që nga momenti i shkëputjes së marrëdhënieve me shërbimin civil, kanë kaluar më shumë se dy vjet, edhe në këtë rast vlen i njëjti arsyetim si për nëpunësin e mësipërm, ***** .

- ***** , i punësuar në pozicionin “Administrator i Ndhmës Ekonomike”, nëpërmjet kontratës individuale të punës datë 01.07.2011. Në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ky punonjës i plotësonte kushtet për të përfituar statusin e punësimit si nëpunës civil, por veprimi i deklarimit të statusit pa të drejtë, nuk është kryer nga ana e njësisë përgjegjëse të Komunës Kryeveidh.

Aktualisht mban pozicionin “Specialist i Ndhmës Ekonomike”, pranë Njësisë Administrative Kryeveidh, detyrë në të cilën ka kaluar me pëlqimin e tij.

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civil, për punonjësin ***** , në pozicionin që mban aktualisht, “Specialist i Ndhmës Ekonomike”, duke qenë se, niveli aktual i nëpunësisë në shërbimin civil, është i njëjtë me atë

që ka përfitur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- Për 3 raste të tjera (të cilët ishin punonjës ekzistues ditën e fillimit të efekteve të ligjit) njësia përgjegjëse me të drejtë ka refuzuar deklarin e statusit të punësimit, pasi ka konstatuar që ata nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor, që kërkonte secili pozicion pune.

Konkretisht, nuk është deklaruar statusi për punonjësit, me arsim të mesëm, si më poshtë:

- ***** , e punësuar në pozicionin “Inspektore Tatimesh” me urdhrin e emërimit nr.01/21 datë 01.07.2011. Nga këqyrja e listëpagesave, rezulton se ka ndërprerë marrëdhënien e punës me dëshirën e saj, me urdhrin e lirimit nr. 37 prot., datë 01.07.2014.

- ***** , i punësuar në pozicionin “Inspektor Veteriner” me urdhrin e emërimit nr.11 datë 29.02.2012. Nga këqyrja e listëpagesave, rezulton se ka ndërprerë marrëdhënien e punës, me vullnetin e tij, në datën 30.06.2015. Nuk është kryer asnjë procedurë.

- ***** , punësuar në pozicionin “Arkiviste” me urdhrin e emërimit nr. 31 datë 31.09.2012. Nga këqyrja e listëpagesave rezulton se në momentin e mbikëqyrjes konstatohet se ka ndërprerë marrëdhënien e punës, me vullnetin e saj, në datën 19.04.2015. Nuk është kryer asnjë procedurë.

Edhe në rastin e punonjësit ***** , i punësuar në pozicionin “Specialist Z.M.M.T. ”, me kontratën individuale të punës datë 03.02.2014, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit kishte vjetërsi në punë në shërbim civil, për një periudhë më pak se një vit, por njësia përgjegjëse me të drejtë nuk ka bërë deklarin e statusit të punësimit, *nëpunës civil në periudhë prove*; pasi nuk përmbushte kriterin e nivelit arsimor, që kërkonte pozicioni i punës. Në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes konstatohet se, punonjësi ***** , ishte larguar nga detyra, me aktin (numër protokollin nuk ka) datë 11.12.2015. (në mënyrë të detajuar shih **Tabelën nr. 2** – *Nëpunës civil në periudhë prove, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*);

Konkluzion:

Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Rrogozhinë ka vepruar drejtë në lidhje me refuzimin e deklarin të statusit të punësimit, si nëpunës civil për punonjësit ***** , ***** , ***** dhe ***** pasi ata nuk përmbushnin kriterin e nivelit arsimor, që kërkonte secili prej pozicioneve të punës.

- Nuk rezultojnë pozicione të lira pune, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

II.b) Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar në ligjin nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil”

II.b.1) Bashkia Rrogozhinë

Nga analiza e dokumentacionit që i është vënë në dispozicion grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 13, datë 14.02.2014 të Këshillit Bashkiak dhe nuk konstatohet asnjë rast, që punonjësit ekzistues të saj, të jenë rekrutuar sipas procedurave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

II.b.2) Komunat Sinballaj, Gosë, Lekaj, Kryevidh, aktualisht Njësi Administrative.

Në lidhje me komunat e mësipërme, të cilat aktualisht janë njësi administrative pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Rrogozhinë, të cilat janë përfshirë për herë të parë në shërbimin civil, më parë marrëdhëniet e punës të punonjësve të tyre rregulloheshin në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ekzistonte ndonjë detyrim, që punësimi të kryhej nëpërmjet procedurës së konkurrimit, qoftë edhe si procedurë e jashtme.

Statusi i nëpunësit civil për punonjësit e tyre, ka lindur për shkak të veprimit të nenit 67, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

II.c) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar

II.c.1) Bashkia Rrogozhinë

Nga analiza e dokumentacionit që kishte në dispozicion grupi i mbikëqyrjes, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkia Rrogozhinë ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr.13, datë 14.02.2014 të Këshillit të Bashkisë Rrogozhinë. Sipas kësaj strukture organizative, kjo bashki ka pasur 16 pozicione pune pjesë e shërbimit civil, pozicione këto, të cilat në të gjitha rastet, janë plotësuar me akte emërimi të përkohshme dhe me kontrata pune, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” i cili ishte efektiv në kohën që janë kryer këto veprime.

Megjithatë, me fillimin e efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pavarësisht shkeljes ligjore të lejuar në lidhje me mënyrën e fillimit të marrëdhënies së punësimit, disa nga punonjësit kanë përfituar statusin e nëpunësit civil, në bazë të nenit 67, të këtij ligji dhe disa nuk e kanë përfituar statusin e nëpunësit civil, për shkak të mospërmbushjes së kërkesave ligjore. Mënyra si është vepruar dhe cilat veprime duhen kryer për rregullimin e situatës së paligjshmërisë, për secilin rast është folur në pjesën e **II.a)** të këtij materiali, me titull: Gjendja e deklaramit të statusit të punësimit në Bashkinë Rrogozhinë, etj. (Faqe 10 – 22)

II.d) Procesi i deklaramit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore

Në bazë të, pikës 2, të Kreut II, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar me VKM nr.532 dt. 06.08.2014), njësitë përgjegjëse në institucionet e pushtetit vendor, duhej të përfundonin procesin e lëshimit të akteve të deklarimit të statusit jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, i cili lejon të drejtën e shtyrjes së këtij afati një herë të vetme nga institucioni, për shkaqe të arsyeshme, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Në njësitë e pushtetit vendor që aktualisht përfshihen në juridiksionin e Bashkisë Rrogozhinë, konstatohet se ky proces është kryer në periudhën prill 2015, pra jashtë afatit ligjor, gjë e cila flet për një punë të pakujdesshme nga ana e njësive përgjegjëse në zbatimin e kërkesave të ligjit. Kurse njësitë përgjegjëse të ish-Komunave Sinaballaj dhe Gosë nuk e kanë kryer aspak procesin e deklarimit të statusit të punësimit. Njësia përgjegjëse e ish Komunës Lekaj ka respektuar afatet ligjore të deklarimit të statusit të punësimit pasi ky proces është kryer në periudhën prill të vitit 2014.

III. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës

Një institut shumë i rëndësishëm, i cili ka lidhje me një sërë institutesh të tjera të ligjit për nëpunësin civil, të tillë si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicione pjesë e shërbimit civil.

Hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, e ngarkoi institucionin e mbikëqyrur, me detyrën e hartimit të përshkrimeve të pozicioneve të punës, brenda një afati të përcaktuar, që ishte data 1 korrik 2014.

Gjatë procesit të verifikimit në institucion u konstatua nga grupi i mbikëqyrjes se, njësia përgjegjëse nuk kishte hartuar përshkrimet e punës sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe në Udhëzimin nr.2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Në lidhje me këtë situatë është mbajtur procesverbal midis, grupit të mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse ***** , me datë 29.01.2016.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, duhet të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për gjithë pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

IV. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil

Në momentin e mbikëqyrjes, u konstatua se në Bashkinë Rrogozhinë nuk ka qenë i miratuar plani vjetor i pranimit në shërbimin civil.

Në lidhje me këtë situatë është mbajtur procesverbal midis, grupit të mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse *****, në datën 29.01.2016.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të përfshijë në planin vjetor të saj edhe nevojat e njësive administrative, subjekt mbikëqyrjeje, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

V. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të kryera pas datës 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes.

Gjatë verifikimit në subjektin e kontrolluar, u konstatua se gjatë kësaj periudhe, janë kryer **8 konkurre** dhe emërimet sipas procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Bëhet fjalë për procedurën e konkurrimit dhe emërimin e punonjësve të mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit të lartë drejtues me aktin e emërimit nr. 1426 prot., dt.29.12.2015);
2. *****, në pozicionin “Konstruktor”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 1323/1 prot., dt.16.12.2015);
3. *****, në pozicionin “Inxhinier Topograf”,(emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv, me aktin e emërimit nr. 1313/1 prot., dt.16.12.2015);
4. *****, në pozicionin “Inxhinier Ndërtimi/ Teknik Ndërtimi” (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv, me aktin e emërimit nr. 1314/1 prot., dt. 15.12.2015);
5. *****, në pozicionin “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues, me aktin e emërimit nr. 1313 prot., dt.15.12.2015);
6. *****, në pozicionin “Jurist” (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 383 prot., dt. 14.05.2015);
7. *****, në pozicionin “Jurist” ,(emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 1314 prot., dt. 15.12.2015);

8. *****, në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 1323 prot., dt.16.12.2015).

Pra, gjatë verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013 “*Për shërbimin civil*”, i ndryshuar, kishte 8 raste të procedurave ligjore të rekrutimeve, lëvizjeve paralele dhe të ngritjes në detyrë në pozicionet pjesë e shërbimit civil. Fillimisht njësia përgjegjëse ka realizuar procedurat për pozicionet:

➤ Në **1 rast** procedura e konkurrimit në Bashkinë Rrogozhinë, niveli ekzekutiv, është kryer para procesit të ristrukturimit të Bashkisë Rrogozhinë.

Më konkretisht, është fjala për konkurrimin e kryer për plotësimin e pozicionit “*Jurist*”:

○ Procedura e konkurrimit për pozicionin “*Jurist*” është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” me shkresën nr. 10 prot., datë 06.03.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, pika 2 dhe pikat nga 5 deri në 10;

○ Komiteti i Përhershëm i Pranimit është krijuar me urdhrin nr. 17, datë 16.03.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, pikat nga 2, deri në 5 dhe pikat 8 dhe 9;

○ Procesi i verifikimit paraprak, i cili ka për qëllim të sqarojë nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave Kreu IV, pikat 1 dhe 3 dhe në përfundim është publikuar edhe shpallja e fituesve, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” si dhe në stendën e informimit të publikut të Bashkisë Rrogozhinë në përputhje me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 4, shkronja “b” pikat 5 dhe 6;

○ Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka kryer vlerësimin (VKM nr. 143, datë 12.03.2014, kreu IV, pikat nga 7 deri në 15) dhe me aktin nr. 1, datë 29.04.2015, ka shpallur fituesit, me renditjen e pikëve. Kandidatja ***** është vlerësuar me shumën totale 75.5 pikë.

○ Publikimi i fituesit është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” sipas përcaktimeve të pikës 7 të Kreut IV të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes të periudhës së provës...*”

Në përfundim të procedurave, për kandidaten ***** të vlerësuar si fituese, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit, nr. 383 prot., dt. 14.05.2015, në pozicionin “*Jurist*”.

➤ Në **5 raste** janë kryer procedura konkurrimi në Bashkinë Rrogozhinë, në nivelin ekzekutiv, pas procesit të ristrukturimit në institucion, si më poshtë:

- *Specialist në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse,*
- *Specialist Jurist në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*
- *Specialist Konstruktor në Drejtorinë e Politikave Urbane,*
- *Specialist Inxhinier Topograf në Drejtorinë e Politikave Urbane,*
- *Specialist Inxhinier Ndërtimi/ Teknik Ndërtimi, në Sektorin Urbanistik.*

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, për kandidatët e vlerësuar si fitues, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e emërimit, e konkretisht:

1. *****, në pozicionin “Konstruktor”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv, me aktin e emërimit nr. 1323/1 prot., dt. 16.12.2015);
2. *****, në pozicionin “Inxhinier Topograf”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv, me aktin e emërimit nr. 1323/1 prot., dt. 16.12.2015);
3. *****, në pozicionin “Inxhinier Ndërtimi/Teknik Ndërtimi”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv, me aktin e emërimit nr. 1314/1 prot., dt. 15.12.2015);
4. *****, në pozicionin “Jurist”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 1314 prot., dt. 15.12.2015);
5. *****, në pozicionin “Specialist i Burimeve Njerëzore”, (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit ekzekutiv me aktin e emërimit nr. 2323 prot., dt. 16.12.2015).

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se në tërësi procedurat e konkurrimit, janë kryer në përputhje me nenet 22, 23 dhe 26 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese” Kreu II “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive” dhe kreu VII “Ngritja në detyrë”.

➤ Në **2 raste** procedura e konkurrimit në Bashkinë Rrogozhinë, është kryer për nivelin e lartë dhe të mesëm drejtues, procedura të kryera pas procesit të ristrukturimit të institucionit si më poshtë:

- Sekretar i Përgjithshëm, kategoria e nivelit të lartë drejtues,
- Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, kategoria e nivelit të mesëm drejtues.

Me Vendimin nr. 29, datë 12.10.2015 “Mbi Propozimin për Fillimin e Procedurave të Konkurrimit për Plotësimin e Vendeve në Nivel të Ulët, të Mesëm dhe të Lartë Drejtues” të Këshillit Bashkiak, në mbështetje të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin e qeverisjes vendore”, neni 8, pika 1 dhe neni 32, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka vendosur miratimin me shumicë votash të projektvendimit “Për Fillimin e Procedurave të Konkurrimit për Plotësimin e Vendeve në Nivel të Ulët, të Mesëm dhe të Lartë Drejtues”.

Më konkretisht, nga verifikimet e kryera rezulton se është vepruar si më poshtë:

- Procedura e konkurrimit për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” është shpallur në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” me shkresën nr. 1080 prot., datë 01.12.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, pika 2 dhe pikat nga 5 deri në 10;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit është krijuar me aktin nr. 810 prot., datë 25.09.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, pikat nga 2, deri në 5 dhe pikat 8 dhe 9;
- Procesi i verifikimit paraprak, i cili ka për qëllim të sqarojë nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave Kreu IV, pikat 1 dhe 3 dhe në përfundim është publikuar dhe shpallja e fituesve dhe me procesverbalin datë 30.12.2015, është dërguar për publikim në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në përputhje me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 4, shkronja “b” pikat 5 dhe 6;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka kryer vlerësimin (VKM nr. 143, datë 12.03.2014, kreu IV, pikat nga 7 deri në 15) dhe me vendimin nr. 1426, datë 29.12.2015, ka shpallur fituesin, me renditjen e pikëve. Kandidati ***** është vlerësuar me 86 pikë dhe në përfundim të procesit është shpallur fitues.
- Publikimi i fituesit është shpallur në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 17.

Në përfundim të procedurave, për kandidatin e vlerësuar si fitues, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit, si më poshtë:

- *****, emërohet në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm” (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, me aktin e emërimit nr. 1426 prot., dt. 29.12.2015).

➤ Në lidhje me konkurrimin për pozicionin, “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” kategoria e nivelit të mesëm drejtues.

- Procedura e konkurimit për pozicionin “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse” është shpallur në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në datën 01.12.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, pika 2 dhe pikat nga 5 deri në 10;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit është krijuar me aktin nr. 810 prot., datë 25.09.2015, sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, pikat nga 2, deri në 5 dhe pikat 8 dhe 9;
- Procesi i verifikimit paraprak, i cili ka për qëllim të sqarojë nëse kandidatët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave Kreu IV, pikat 1 dhe 3 dhe në përfundim është publikuar dhe shpallja e fituesve dhe me procesverbalin datë 25.09.2015, është dërguar për publikim në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në përputhje me Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 4, shkronja “b” pikat 5 dhe 6;
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit ka kryer vlerësimin (VKM nr. 143, datë 12.03.2014, kreu IV, pikat nga 7 deri në 15) dhe me vendimin nr. 1313, datë 15.12.2015, ka shpallur fituesin, me renditjen e pikëve. Kandidati ***** është vlerësuar me shumën totale 83 pikë. Në përfundim të procesit është shpallur fitues *****.

o Publikimi i fituesit është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, pika 17.

Në përfundim të procedurave, për kandidatin i vlerësuar si fitues, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e emërimit, me përmbajtjen e mëposhtme:

- *****, emërohet në pozicionin “*Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse*” (emëruar në shërbimin civil në kategorinë e nivelit të mesëm drejtues, me aktin e emërimit nr. 1313 prot., dt. 15.12.2015.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, në tërësi procedurat e konkurrimit të analizuar në këtë rubrikë, janë kryer në përputhje me nenin 8, pika 1 dhe nenin 32, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në lidhje me sa më sipër, u konstatuan **2 raste** në të cilat njësia përgjegjëse e kishte zbatuar gabim ligjin; konkretisht, ka përdorur institutin e transferimit, në një kohë kur duhej të kishte vepruar në përputhje me procedurat e ngritjes në detyrë, apo lëvizje paralele për pozicionet pjesë e shërbimit civil. Bëhet fjalë për punonjësit ***** dhe *****. Në këto raste problemi qëndron si më poshtë:

- *****, emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit Ekonomik*”, në datë 07.03.2002 dhe deklaruar me statusin e punësimit si nëpunës civil, me aktin e deklarimit nr. 323 prot., datë 20.04.2015 në atë pozicion. Me urdhrin nr. 583 prot., datë 04.08.2015, është transferuar në pozicionin “*Drejtor i Politikave Urbane*”.

Komisioneri vlerëson se, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt sepse nuk janë respektuar kërkesat e ligjit. Nëse do të ishim para një transferimi të përkohshëm për nevoja të ngutshme pune, kjo duhej shënuar në aktin e transferimit/komandimit dhe duhej vënë shkakun i ngutshëm dhe afati, në përfundim të të cilit nëpunësi në fjalë duhej të kthehej në vendin e mëparshëm të punës.

Por veprimi i drejtë për plotësimin e atij pozicioni, për çdo arsye qoftë, do të ishte çelja e procedurës së konkurrimit nëpërmjet lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, etj., sipas rregullave të përcaktuara në nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- *****, “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave*” emëruar me urdhrin nr. 10/9 prot., datë 10.09.2013. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e ka gjetur në këtë pozicion. Meqenëse në dt. 26.02.2014, kishte më pak se një vit punë si “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Tatim-Taksave*” duhej që deklarimi i statusit të punësimit të bëhej “*nëpunës civil në periudhë prove*” në këtë pozicion. Me urdhrin nr. 07 prot., datë 07.11.2014, pa përfunduar ligjërisht periudhën e provës dhe pa respektuar procedurën e lëvizjes paralele, kalon në pozicionin “*Përgjegjës i Shërbimeve Publike*” dhe është deklaruar nëpunës civil në këtë pozicion me aktin nr. 330, datë 20.04.2015, pa përfunduar periudhën e provës dhe pa u konfirmuar si nëpunës civil. Aktualisht, ky nëpunës, është i punësuar në Bashkinë Rrogozhinë, në pozicionin “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Shërbimeve Publike*”.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin e transferimit nr. 583, datë 04.08.2015 dhe të rishikojë mundësinë e kthimit të nëpunësit Saimir Kasemi në pozicionin “Përgjegjës Sektori Ekonomik” në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Rrogozhinë. Pozicioni i punës “Drejtor i Politikave Urbane”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndërsa për punonjësinn *****; Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të revokojë aktin e transferimit nr. 07 prot., datë 07.11.2014, të kthejë nëpunësin në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit Tatim-Taksave”, i cili aktualisht është i lirë dhe të zgjidhë problemin e përmbylljes së periudhës së provës duke plotësuar gjithë kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës “Përgjegjës i Shërbimeve Publike”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Konstatim

Nga analiza e materialeve të administruara, rezulton se në Sektorin e Financës në Drejtorinë Ekonomike është përfshirë pozicioni i punës me emërtesën “Specialist Llogaritar”. Bëhet fjalë për punonjësinn *****; i punësuar në pozicionin “Llogaritar i parë”, me urdhrin e emërimit nr. 1, datë 14.06.2007 dhe aktualisht i punësuar në pozicionin “Specialist Llogaritar”, pranë Bashkisë Rrogozhinë. Ky pozicion pune është përfshirë gabimisht në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil pasi, nisur nga puna që kryen dhe sipas Rregullores dhe kategorizimit të pagës rezulton se, ky pozicion pune nuk duhet të kishte emërtesën specialist llogaritar, pasi ky pozicion pune nuk është pjesë e shërbimit civil, ç’ka duhet rregulluar në strukturat e ardhshme. Në këtë moment konstatohet se, me të drejtë nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është deklaruar statusi i punësimit si nëpunës civil për këtë punonjës.

Në kuptim të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 15.03.2015, Komisioneri vlerëson se, pozicioni i punës me emërtesën “Llogaritar”, nuk kategorizohet si pozicion pune, pjesë e shërbimit civil. Gjatë miratimit të strukturës përfundimtare të institucionit, njësia përgjegjëse, duhet të tregojë kujdes që emërtesat e pozicioneve të punës të përputhen me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe me kërkesat e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, në mënyrë që të pasqyrohet hierarkia institucionale si dhe rolet dhe funksionet e pozicioneve të shërbimit civil, të këtij institucioni.

VI. Rekrutimet në kundërshtim me ligjin, pas hyrjes në fuqi të ligjit për nëpunësin civil

Gjatë procesit të mbikëqyrjes grupi i punës konstatoi se, në Bashkinë Rrogozhinë, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në **7 raste**, janë

emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme, pa respektuar procedurat përkatëse për pranimin në shërbimin civil.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

***** - ka filluar punë me urdhrin nr. 05, datë 07.11.2014 në pozicionin “*Inspektore në Sektorin e Taksave*”;

***** - ka filluar punë me urdhrin nr. 819, datë 28.09.2015 në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin Juridik*”;

***** - ka filluar punë me urdhrin nr. 19, datë 14.05.2015 në pozicionin “*Arkiv Protokoll*”;

***** - ka filluar punë me urdhrin nr. 636, datë 20.08.2015 në pozicionin “*Jurist*”;

***** - ka filluar punë me urdhrin nr. 1294, datë 10.12.2015 në pozicionin “*Arkiv Protokoll*”;

***** - ka filluar punë me kontratë pune, datë 12.02.2015 në pozicionin “*Specialist Finance*”;

***** - ka filluar punë me kontratë pune, datë 06.07.2015 në pozicionin “*Specialist Arkiv-Protokoll*”.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, njësia përgjegjëse, duhet të revokojë aktet e emërimit si më poshtë, pasi kanë dalë pa u respektuar procedurat e parashikuara nga ligji nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*” i ndryshuar dhe për këtë arsye, pozicionet e punës të shpallen të lira dhe të plotësohet sipas kërkesave të ligjit.

1. Aktin nr. 05, datë 07.11.2014, për punonjësen *****, në pozicionin e punës “*Inspektore në Sektorin e Taksave*”;
2. Aktin nr. 819, datë 28.09.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Përgjegjës në Sektorin Juridik*”;
3. Aktin nr. 19, datë 14.05.2015, për punonjësen *****, në pozicionin e punës “*Arkiv Protokoll*”;
4. Aktin nr. 636, datë 20.08.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Jurist*”;
5. Aktin nr. 1294, datë 10.12.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Arkiv Protokoll*”;
6. Akin (numër potokolli nuk ka), datë 12.02.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Specialist Finance*”;
7. Akin (numër potokolli nuk ka), datë 06.07.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “*Specialist Arkiv-Protokoll*”.

VII. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës ka konstatuar se për periudhën objekt mbikëqyrje procedura e transferimit të përkohshëm nuk ka asnjë rast të evidentuar.

Ndërsa në lidhje me transferimet e përkohshme, situata qëndron si më poshtë:

Duke analizuar statistikat e grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rezultoi se, situata aktuale, e krijuar pas ndryshimeve të ndodhura për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, mbështetur në ligjin nr. 30/2015, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, është e materializuar në strukturën e miratuar nga Kryetari i Bashkisë me Urdhrin nr. 581 prot, datë 04.08.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Rrogozhinë”.

Bazuar në këtë strukturë, e cila është aktualisht në fuqi, numri i përgjithshëm i miratuar nga Këshilli Bashkiak është **101** punonjës, prej të cilëve vetëm **47** janë pjesë e shërbimit civil. Kjo situatë është e evidentuar në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 3** - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil të Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësie Administrative për vitin 2015” që është pjesë e këtij raporti.

Gjendja e shërbimit civil ditën e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, indryshuar, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë : Situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014.

Nr.	Institucioni	Punonjës gjithsej	Pozicione në shërbimin civil
1	Bashkia Rrogozhinë	39	16
2	Komuna Sinaballaj	7	4
3	Komuna Gosë	15	7
4	Komuna Lekaj	23	11
5	Bashkia Kryevidh	41	11
Totali		125	49

Duke e krahasuar gjendjen e institucionit në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, që përkon me datën 26.02.2014, me strukturën që është aktualisht në fuqi, gjendja paraqitet si vijon:

Numri total i punonjësve të Bashkisë Rrogozhinë së bashku me komunat, që janë bërë pjesë e kësaj njësie të pushtetit vendor, nga **125 punonjës** që ishin në strukturën e mëparshme, në strukturën aktuale (të miratuar me urdhrin nr. 581 dt. 04.08.2015) janë **101 punonjës**, pra ka një ulje me rreth **20 %**, ndërsa pozicionet e shërbimit civil nga **49 pozicione** që ishin në

strukturën e mëparshme, aktualisht, me strukturën e vitit 2015, ka **47 pozicione** pune në shërbimin civil, duke shënuar një ulje të vogël të numrit të punonjësve në shërbimin civil.

Kjo do të thotë se ky institucion është përfshirë në proces ristrukturimi, i cili në thelbin e tij përmban jo vetëm shkurtime në pikëpamjen numerike por dhe riorganizime nga pikëpamja e përmbajtjes të pozicioneve të punës.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, nuk ka treguar kujdes në realizimin e procedurës së ristrukturimit dhe nuk ka mbajtur parasysh kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” dhe Udhëzimin nr. 3, datë 14.04.2014 “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit” të Departamentit të Administratës Publike.

Në kuadër të detyrës së caktuar, për verifikimin e mënyrës së zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, grupi i punës inspektoi gjithë procedurën e krijimit, funksionimit dhe konkluzionet e Komisionit të Ristrukturimit, prej nga rezultoi se: me urdhrin nr. 581/1 prot., datë 24.08.2015, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit, sipas përbërjes së përcaktuar bazuar në pikën 3 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe Kreun III, pika 18, të Vendimit nr. 171 dt. 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civil...”.

Në këtë akt konstatohet se, nga ana e institucionit ka një kuptim të drejtë të dispozitave të mësipërme në lidhje me mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të Komisionit të Ristrukturimit. Në përbërjen e tij janë përfshirë tre përgjegjës sektori.

Procedura e ndjekur nga Komisioni i Ristrukturimit nuk është bërë konform ligjit, pasi nuk janë respektuar të gjitha kërkesat e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu dhe të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”. Vërehet se ka disa parregullësi në lidhje me lirimet nga shërbimi civil në njësitë administrative Sinaballaj, Gosë dhe Lekaj, ndërsa dëmshpërblimi është përlllogaritur, në përputhje me vjetërsinë në punë sipas pikës 7, të nenit 50 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Aktet e emërimit janë individuale dhe riemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët, janë bërë duke marrë paraprakisht deklarinimin me shkrim të nëpunësit nëse jep pëlqimin ose jo për detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit” të VKM nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” .

Proceset e punës në këtë institucion disiplinohen nëpërmjet Rregullores së Brendshme të institucionit, në të cilën janë shprehur mjaft qartë detyrat për secilin pozicion pune. Por konstatohet se mungojnë kriteret specifike mbi të cilat duhet të kryhen pranimet në shërbimin

civil. Kjo mangësi do të rregullohej nëse do të ishin përshkrimet individuale të punës, të cilat mungojnë.

• Gjatë verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, procedura e transferimit të përhershëm, është zbatuar drejt në **12 raste** dhe konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune në datën 01.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, pranë ish Komunës Kryeviidh, aktualisht njësia administrative Kryeviidh. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Politikave Urbane”.
2. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune në vitin 1992 në pozicionin “Arkivist-Protokollist”, pranë ish Komunës Sinaballaj, aktualisht njësia administrative Sinaballaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Arkivist-Protokollist”.
3. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune në vitin 1992 në pozicionin “Specialist në Zyrën e Financës”, pranë ish Komunës Sinaballaj, aktualisht njësia administrative Sinaballaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë me urdhrin n.3, datë 20.05.2013 në pozicionin “Inspektor i Taksave dhe i Tarifave”.
4. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 04, datë 06.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë ish Komunës Gosë, aktualisht njësia administrative Gosë. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin, “Specialist Finance”. (ka deklaratë pranimit, zbritje në detyrë).
5. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 04/11, datë 06.07.2011 në pozicionin “Jurist dhe Punonjës Arshive”, pranë ish Komunës Gosë, aktualisht njësia administrative Gosë. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Jurist”.
6. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune, në datën 03.01.2012 në pozicionin “Përgjegjës i Administratës”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht njësia administrative Lekaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Arkivist-Protokollist”. (ka deklaratë pranimit, zbritje në detyrë).
7. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune, në datën 01.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht njësia administrative Lekaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Specialist Finance”. (ka deklaratë pranimit, zbritje në detyrë).
8. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune, në datën 03.01.2012 në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës Përkrahjes Sociale”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht njësia administrative Lekaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë në pozicionin “Specialiste e Ndihmës Ekonomike”. (ka deklaratë pranimit, zbritje në detyrë).

9. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune, në datën 01.07.2011 në pozicionin “Përgjegjëse e Zyrës Tatim Taksave”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht njësia administrative Lekaj. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë, me urdhrin nr. 635 prot., datë 20.08.2015 në pozicionin “Inspektore Tatim Taksash”. (ka deklaratë panimi, zbritje në detyrë).
10. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 01/23 prot., në datën 01.07.2011 në pozicionin “Jurist”, pranë ish Komunës Kryevadh, aktualisht njësia administrative Kryevadh. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë, në pozicionin “Jurist”.
11. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune në datën 01.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Tatimeve”, pranë ish Komunës Kryevadh, aktualisht njësia administrative Kryevadh. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë, në pozicionin “Specialist Tatim Taksash”. (ka deklaratë pranimi, zbritje në detyrë).
12. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune në datën 03.02.2014 në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Z.M.M.T”, pranë ish Komunës Kryevadh, aktualisht njësia administrative Kryevadh. Transferuar në Bashkinë Rrogozhinë, në pozicionin “Specialist Bujqësie”. (ka deklaratë pranimi, zbritje në detyrë).

VIII. Rastet e lirimit për shkak të ristrukturimit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, grupi i punës ka konstatuar se, në Bashkinë Rrogozhinë dhe në njësinë administrative Kryevadh, nuk është evidentuar asnjë rast lirimi, nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi.

Ndërsa, në ish komunat, aktualisht njësitë administrative Sinaballaj, Gosë dhe Lekaj evidentohen **9 raste** lirimi, nga shërbimi civil për shkak ristrukturimi, ndër të cilat në një rast punonjësi është ankuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Evidentohet dhe **një rast** lirimi, nga shërbimi civil, pa akt administrativ mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në ish komunën Lekaj, aktualisht njësi administrative e Bashkisë Rrogozhinë.

Konkretisht bëhet fjalë për lirimet e punonjësve:

1. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 69 prot., datë 31.05.2011, në pozicionin “Administratore Shoqërore”, pranë ish Komunës Sinaballaj, aktualisht e liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 638 prot., dt. 20.08.2015, për shkak ristrukturimi.
2. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 2 prot., dt.20.05.2013, në pozicionin punonjës në “Zyrën e Financës”, pranë ish Komunës Sinaballaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 639 prot. dt. 20.08.2015, për shkak ristrukturimi.

3. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 04/5 prot., datë 06.07.2011, në pozicionin “Përgjegjës Zyrës Tatimeve”, pranë ish Komunës Gosë, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 735 prot. dt. 10.09.2015, për shkak ristrukturimi.
4. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 04/8 prot., datë 06.07.2011 në pozicionin “Përgjegjës Zyrës Burimeve Njerëzore, Administrim dhe Ndihmë Ekonomike”, pranë ish Komunës Gosë, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr.735 prot. dt. 10.09.2015, për shkak ristrukturimi.
5. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 9 prot., datë 20.11.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 610/2 prot. dt. 12.08.2015, për shkak ristrukturimi.
6. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 9 prot., datë 30.06.2011, në pozicionin “Specialist Blegtorie”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 642 prot., dt. 20.08.2015, për shkak ristrukturimi.
7. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 5 prot., datë 15.02.2012, në pozicionin “Specialist Finance”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 642 prot., dt. 20.08.2015, për shkak ristrukturimi.
8. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 2 prot., datë 01.08.2011, në pozicionin “Specialist Bujqësie & Agronom” me akt deklarimi të statusit të punësit, (numër protokolli nuk ka), datë 11.04.2014, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 735 prot. dt. 10.09.2015, për shkak ristrukturimi.
9. ***** – Emëruar me kontratë individuale pune, (numër protokolli nuk ka) datë 01.07.2011, në pozicionin “Inspektor Tatim Taksave”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar pa akt administrativ mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.
10. ***** – Emëruar me urdhrin nr. 9, datë 20.11.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, pranë ish Komunës Lekaj, aktualisht i liruar me urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nr. 610/2 prot. dt. 12.08.2015, për shkak ristrukturimi. Në këtë rast punonjësi është ankuar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Pozicionet e punët, të listuara në këtë rubrikë, janë trajtuar në mënyrë të hollësishme gjatë analizës të situatës së shërbimit civil, në njësitë administrative përkatëse.

Në këtë moment vlen të theksohet se, Komisioni i Ristrukturimit, nuk ka treguar kujdesin e duhur për respektimin e të drejtave që parashikon pika 8, e nenit 50 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar, për punonjësit *****, ***** dhe *****, të cilët në momentin e mbikëqyrjes rezultojnë të liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Pra jemi përpara faktit që, nëpunësve i është mohuar e drejta për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Në rastin e nëpunësit ***** njësia e burimeve njerëzore e ka riemëruar në pozicionin e punës "Agronom", me aktin e emërimit numër 1548 prot., datë 14.07.2016, pranë ish komunës Gosë, aktualisht njësia administrative e Bashkisë Rrogozhinë duke respektuar të drejtën që gëzon në bazë të pikës 8, të nenit 50, të ligjit në fjalë, që brenda një periudhe 2-vjeçare, mund të konkurronte nëpërmjet lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, etj., në pozicione të njëvlerëshme brenda shërbimit civil.

Ndërsa në rastin e nëpunësit Bashkim Greca mungon akti mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, njësia përgjegjëse, në zbatim të pikës 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duhet të t'i njoftojë këta nëpunës në lidhje me të drejtën që i njeh kjo dispozitë, që brenda një periudhe 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, këta punonjës kanë të drejtë të konkurrojnë për procedurat e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji, etj.

IX. Pezullimi nga shërbimi civil

Grupi i mbikëqyrjes ka konstatuar se, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë dhe ish Komunat, aktualisht njësi administrative nuk ka pasur asnjë rast pezullimi nga shërbimi civil.

X. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që na është vënë në dispozicion, lidhur me zbatimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë, u konstatua se në Bashkinë Rrogozhinë si dhe në ish-Komunat që përfshihen në të, deri në momentin e realizimit të kësaj mbikëqyrje, janë **kryer 5 procedime disiplinore** për disa punonjës.

Masat disiplinore janë dhënë pa u zbatuar procedura që kërkon ligji dhe në lidhje me këtë situatë është mbajtur procesverbal midis, grupit të mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse z. Besmir Pone, me datë 29.01.2016.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë dhe e Komunave, aktualisht njësi administrative, duhet të rivlerësojë këto procedura, pasi nuk ka vepruar drejt në lidhje me respektimin e procedurës ligjore, sipas neneve 57 deri në 60, të Kreut të X, të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 115 dt. 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore..."

Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të ndjekë me përparësi procesin e zbatimit të procedurës së kërkuar nga dispozitat e sipërpërmendura, duke filluar që nga momenti i propozimit për fillimin e ecurisë disiplinore; vlerësimit të rastit nëse

do të trajtohet nga eprori direkt apo nga Komisioni i Disiplinës; ngritja e Komisionit të Disiplinës dhe njohja e anëtarëve të Komisionit të Disiplinës me të drejtat dhe detyrimet që ata kanë gjatë shqyrtimit të një ecurie disiplinore; përzgjedhjes së masës së përshtatshme disiplinore, etj., ashtu siç përcaktohet në aktet dhe dispozitat ligjore, të sipërpërmendura.

XI. Vlerësimi i rezultateve në punë

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, (Kreu XI, neni 62), përcakton detyrimin e institucioneve për të vlerësuar punën e çdo punonjësi që kryen funksione në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, dhe në fund të çdo viti, kur viti i vlerësimit për nëpunës civil të konfirmuar është i njëjtë me vitin kalendarik, me përjashtim të vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, ku viti i vlerësimit llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil. Për realizimin e një vlerësimi sa më objektiv, në Vendimin Nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” është përcaktuar një procedurë e hollësishme në lidhje me kompetencat e aktorëve që marrin pjesë në këtë proces dhe mënyrën e kryerjes së këtij procesi.

Në kuptim të pikës 12, Kreu II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë” procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili kalon në fazat e mëposhtme:

- Planifikimi, ku zyrtari raportues gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit dhjetor, cakton për nëpunësin civil që do të vlerësohet, objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues, pra eprori direkt, së bashku me nëpunësin që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- Bisedimet e ndërmjetme. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen gjatë vitit, çdo katër mujor, ku zyrtari raportues takohet me nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.
- Vlerësimi përfundimtar, i cili realizohet në periudhën 15 nëntor - 15 dhjetor dhe konsiston në vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen

e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Grupi i punës pas kontrollit të ushtruar në lidhje me procesin e vlerësimeve të nëpunësve, në zbatim të nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, konstatoi se, nuk ishin kryer vlerësime të rezultateve individuale në punë, për nëpunësit civil të Bashkisë Rrogozhinë dhe ish-Komunave, aktualisht Njësi Administrative, në asnjë rast.

Në lidhje me këtë situatë, është mbajtur procesverbal midis, grupit të mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse ***** , më datë 29.01.2016.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë dhe ish-Komunave nuk kanë bërë vlerësimet e rezultateve të punës të punonjësve konform nenit 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014 “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, gjë e cila flet për një qëndrim të pakujdesshëm në kryerjen e detyrës nga njësia e burimeve njerëzore. Në këtë rast kemi të bëjmë me një detyrim ligjor të pa plotësuar, i cili krijon kushtet ligjore, për funksionimin e sistemit dhe elementëve të shërbimit civil, si psh, në rastet kur nëpunësi civil mund të jetë i interesuar të bëjë lëvizje paralele, apo të kërkojë zhvillimin e karrierës, nëpërmjet procedurave të ngritjes në detyrë, etj.

Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të fillojë menjëherë punën për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, për vitin 2016 për pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës, apo formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në nenin 62 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.

XII. Dosja e personelit dhe regjistri i personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit, grupi i punës verifikoi të gjitha dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administruhen në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se mungonin dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, rezultoi se në çdo dosje janë të administruara dokumentet e identifikimit (fotokopje e pasaportës); ndërkohë që mungonin nga dosjet individuale të disa nga nëpunësve, dokumente që tregojnë për gjendjen civile (certifikata e gjendjes familjare); dokumente që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumente që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (certifikata kualifikimi), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit. Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në Aneksin nr. 2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil Bashkia Rrogozhinë dhe ish - Komunat”.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në Bashkinë Rrogozhinë dhe në ish komunat, aktualisht njësi administrative ka 47 pozicione pune në shërbim civil, nga të cilat:

- 7 pozicione janë të lira,
- 31 nëpunës janë meshkuj dhe 9 femra,
- Mosha mesatare për meshkujt është 45 vjeç,
- Mosha mesatare për femrat është 39 vjeç,
- Mosha mesatare në total është 42 vjeç.

Përsa i përket arsimit të nëpunësve pranë Bashkisë Rrogozhinë, konstatohet se:

32 nëpunës janë me arsim të lartë, nga të cilët:

- 25 nëpunës zotërojnë diplomë të universiteteve publike
- 7 nëpunës zotërojnë diplomë të universiteteve jopublike, private
- 10 nëpunës janë me arsim të mesëm

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, dhe e Komunave, aktualisht njësi administrative, nuk ka vepruar drejt dhe nuk ka treguar kujdes në lidhje me përmbushjen e kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Rrogozhinë, duhet të plotësojë dosjen individuale të çdo nëpunësi civil duke ju përmbajtur kërkesave ligjore.

Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrur u konstatua se, nuk ka regjistër personeli.

Në lidhje me këtë situatë, është mbajtur procesverbal midis, grupit të mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Shërbimeve Mbështetëse ***** , në datën 29.01.2016.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të fillojë menjëherë punën për krijimin e regjistrit të personelit, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Ky veprim është në koherencë dhe me punën për të hedhur të dhënat në Regjistrin Kombëtar të Nëpunësve Civilë, që administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

*
* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Rrogozhinë, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme respektive për Bashkinë Rrogozhinë, dhe Komunat Sinaballaj, Gosë, Lekaj dhe Kryevidh, aktualisht njësi administrative të Bashkisë Rrogozhinë, të cilat janë pjesë e këtij raporti.

1. **Aneksi 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014)”
 - Tabela nr. 1 - Nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014),
 - Tabela nr. 2 - Nëpunës civilë në periudhë prove, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (data 26.02.2014),
 - Tabela nr. 3 - Nëpunës civilë, të cilëve nuk iu është deklaruar statusi i punësimit,
 - Tabela nr. 4 - “Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil, pezullime dhe transferime”.
2. **Aneksi 2** - “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, Bashkia Rrogozhinë dhe ish - Komunat”.

- 3. Aneksi 3** - *“Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil të Bashkisë Rrogozhinë dhe Njësive Administrative për vitin 2016”*.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA